



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 46/2012
Prishtinë, më 25. 01. 2012, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatçija, Sala Berisha - Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Fikrim Damka, Berat Buzhala, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi dhe Myzejene Selmani.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi – ZPRK, Haxhi Gashi – USAID, Delotte, Brian Kemple dhe Besim Latifi - USAID/ BEEP dhe Florije Mehmeti - KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti, dhe konsulentja e Komisionit - Brikena Hoxha.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-94 për shërbimet e shoqërisë informatike;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-98 për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit nr. 03/L-168 për turizmin dhe për shërbimet turistike;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – Kërkoj që rendi i ditës të ndryshohej ose të fuzionohej, në mënyrë që të diskutoheshin të tri projektligjet si një pikë e rendit të ditës, pra: *Shqyrtimi në parim i projektligjeve si vijon: Projektligji nr. 04/L-94 për shërbimet e shoqërisë informatike, Projektligji nr. 04/L-98 për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror, Projektligji nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe për plotësimin e ligjit nr. 03/L-168 për turizmin dhe për shërbimet turistike.*

Propozimi u përkrah nga Komisioni.

2. Shqyrtimi në parim i projektligjeve si vijon: Projektligji nr. 04/L-94 për shërbimet e shoqërisë informatike; Projektligji nr. 04/L-98 për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror, Projektligji nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit nr. 03/L-168 për turizmin dhe për shërbimet turistike.

Kryetari – Theksoi se sipas Rregullores së Kuvendit, para leximit të parë të projektligjeve, komisionet funksionale i shqyrtojnë në parim projektligjet. Kërkoj nga deputetët tash t'i paraqesin vërejtjet e tyre në parim ose të rezervohen që t'i paraqesin në grupet e punës. Njëkohësisht propozoi që për këto tri projektligje, që janë në shqyrtim në parim, të formohen grupe pune prej tre anëtarëve. Në fund kërkoj nga stafi mbështetës i Komisionit të ftohen në mbledhjet e grupeve të punës të gjitha organizatat që kanë projekte mbështetëse për Kuvendin ose për Qeverinë që të japin kontributin me ekspertiza apo konsulencë në përkrahje të punës së Komisionit.

Sala Berisha – Shala - Këto tri projektligje është mirë të miratohen në parim, që të dërgohen me kohë në seancën plenare, që pastaj të hapet procedura për shqyrtim dhe për amendamentimin nëpër grupet e punës. Ajo vlerësoi si imediate miratimin e Projektligjit për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohen në parim Projektligji nr. 04/L-94 për shërbimet e shoqërisë informatike; Projektligji nr. 04/L-98 për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror dhe Projektligji nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit nr. 03/L-168 për turizmin dhe për shërbimet turistike.

Kuvendit e parashtrohet këtë

Rekomandim

1. Të miratohen në parim, Projektligji nr. 04/L-94 për shërbimet e shoqërisë informatike; Projektligji nr. 04/L-98 për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror dhe Projektligji nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit nr. 03/L-168 për turizmin dhe për shërbimet turistike.

2. Arsyetimin me rekomandime e paraqet deputeti Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në lidhje me formimin e grupeve të punës, pas diskutimeve, Komisioni njëzëri e nxori këtë

V E N D I M

- 1. Formohen grupet e punës për shqyrtimin e projektligjeve si vijon:*
 - a) Projektligjit nr. 04/L-94 për shërbimet e shoqërisë informatike;*
 - b) Projektligjit nr. 04/L-98 për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror;*
 - c) Projektligjit nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit nr. 03/L-168 për turizmin dhe për shërbimet turistike;*
- 2. Grupet e punës kanë këtë përbërje: Teuta Sahatçija, raportuese; Fikrim Damka dhe Berat Buzhala për Projektligjin nr. 04/L-94 për shërbimet e shoqërisë informatike; Sala Berisha – Shala, raportuese, Visar Ymeri dhe Lutfi Zharku për Projektligjin nr. 04/L-98 për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror; Hashim Deshishku, raportues, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq për Projektligjin nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit nr. 03/L-168 për turizmin dhe për shërbimet turistike;*
- 3. Secili anëtarë i Komisionit, sipas interesimit, mund t'i bashkëngjitet grupit të punës gjatë punës së tij;*
- 4. Grupi i punës në bashkëpunim me Njësinë Koordinuese të Komisionit të hartojë planin e veprimt dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe për miratim në Komision.*

3. Të ndryshme

Çështje vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit